



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 615 Prot.

Tiranë, më 26 / 05 / 2020

**Lënda:** Sugjerime mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.9669, date 18.12.2006, "Per Masat Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare", të ndryshuar.

**Z. ULSI MANJA**  
**KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT.**

*Për dijeni:*

**Z. GRAMAZ RUCI**  
**KRYETAR**  
**KUVENDI I SHQIPËRISË**

**I nderuar Z. Manja,**

Në vijim të kërkesës Tuaj, për të dhënë sugjerime në lidhje me projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.9669, date 18.12.2006, "Per Masat Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi u konsultua mbi këtë projekt-ligj dhe me ligjin aktual, jep propozimet si më poshtë:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Per Masat Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare", të ndryshuar, ka parashikime në përputhje me "Konventën e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje" dhe ka reflektuar rekomandimet e GREVIO për Shqipërinë, mbi zbatimin e kësaj Konvente. Mendojmë se ka disa

aspekte të tjera të cilat kanë nevojë për rishikim në Ligjin nr. 9669/2006 "Per Masat Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare", i ndryshuar.

❖ Duke iu referuar Raportit të GREVIO për Shqipërinë, të vitit 2017, në zbatim të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, autoritetet nxiten që në legjislacionin e tyre duhet të kenë një qasje më të qartë gjinore, për të njohur plotësisht natyrën me bazë gjinore të dhunës në familje, e cila prek kryesisht gratë dhe vajzat. Studimi me i fundit i OSBE (2019) mbi dhunën ndaj grave në Shqipëri e verteton kete.

Propozojmë që të bëhet parashikimi i tyre, si një kategori veçanërisht e mbrojtur, ashtu siç është bërë në ligj për fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar.

Për këtë arsye, Komisioneri në nenin 1 "Qëllimi" i Ligjit nr. 9669/2006 "Per Masat Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare", i ndryshuar, propozon të shtohet edhe termi, "gratë".

Neni 1 pika 2, sipas propozimit të Komisionerit:

2. "Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuar, grave, si dhe të çdo individ, subjekt i këtij ligji, sipas nenit 3, të tij, që paraqet nevoja të veçanta mbrojtjeje."

❖ Ligji nr. 9669/2006 "Per Masat Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare", i ndryshuar, në tërësinë e tij, duhet të jetë në të njëjtën frymë me Konventën e Stambollit, ku gjen mbrojtje krahas "dhunës në familje" edhe "dhuna ndaj grave" në mënyrë të veçantë. Rekomandimet e GREVIO e vendosin theksin specifikisht në dhunën dhe diskriminimin ndaj grave, ndaj mendojmë së përfshirja e këtij përkufizimi sjell një përjasje me këtë Konventë. Gjithashtu, "Dhuna ndaj grave" parashikohet si diskriminim në nenin 3 të Konventës së Stambollit. Në nenin 3, tek "Përkufizimet" e Ligjit nr. 9669/2006 "Per Masat Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare", propozojmë të shtohet përkufizimi i "Dhunës ndaj Grave".

Ky parashikim do të bëjë të mundur edhe fuqizimin e rolit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të rritur ndërgjegjësimin dhe parandalimin rreth natyrës diskriminuese të dhunës ndaj grave<sup>1</sup>, në mënyrë specifike.

Propozimi i Komisionerit për formulim si më poshtë:

---

<sup>1</sup> Rekomandim GREVIO: Autoritetet duhet të studiojnë mjetet e mundshme për të rritur ndërgjegjësimin rreth natyrës diskriminuese të dhunës ndaj grave, si dhe të fuqizojnë rolin e Avokatit të Popullit dhe të Komisionerit kundër Diskriminimit, si mbrojtës të viktimave të dhunës ndaj grave.

Neni 3 “Përkufizimet”:

*“Dhunë Kundër Grave” kuptohet: si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore, që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike të grave, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private.*

❖ Në nenin 21 në Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Per Masat Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, të ndryshuar, tek Ankimi ku parashikohet se: “Kundër vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes dhe vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes mund të bëhet ankim. Ankimi paraqitet brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose nga dita e marrjes dijeni.” Termi “nga dita e shpalljes së vendimit “ duhet të hiqet pasi sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Civile fillimi i afateve të ankimit,<sup>2</sup> sipas ndryshimeve të vitit 2017, bëhet nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar dhe jo nga momenti i shpalljes.

Duke besuar që mendimet Tona të merren në konsideratë, shprehim angazhimin institucional për bashkëpunime të mëtejshme.

**KOMISIONERI**  
  
**ROBERT GAJDA**  


<sup>2</sup> Neni 444 I K.Pr.Civile